

VENDIM
Nr. 177, datë 25.3.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURISË NR. 7/291, ZONA KADASTRALE 8330, TIRANË, DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 568, DATË 23.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR AGJENCINË E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “a”, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë 7/291, zona kadastrale 8330, Tiranë, me sipërfaqe ndërtese 708.5 (shtatëqind e tetë pikë pesë) m² dhe sipërfaqe trualli 1 033 (një mijë e tridhjetë e tre) m², sipas planrilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve administrative të Bashkisë Tiranë.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Vendimi nr. 568, datë 23.8.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, shfuqizohet.

4. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI AGJENCIA SHETETERORE E KADASTRES

DATE 20.12.2020

QELIMI PER KALIM PRONESIE

VENDNDODHJA

BASHKIA TIRANE

DVASHK TIRANE VERI

ZONA KADASTRALE 8330

NUMRI PASURISE 7/291

INDEX HARTE TR; L-11

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE TRUALL

SIP.PASURISE SIPAS KPP = 980.0 m2

SIPERFAQE GJURMES NDETIMIT = 708.5 m2


NUMRI KATEVE 1,2,3

NUMRI PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 484444
Y 4578181

X 484581
Y 4578181



X 484444
Y 4578085

SH 1 : 500

X 484581
Y 4578085

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			7/425, 6/136		
2	JUG			7/292		
3	LINDJE			7/87		
4	PERENDIM			7/425, 7/7		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI:

LICENCA: NR. DATE

KOMPANIA:

NIPT:

NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI SHPETIM KORMAKU

ASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMO!

PERGJEGJESI ANGELO MEZINI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, O, Z, D

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:HK

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI AGJENCIA SHETETERORE E KADASTRES

NENSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale